



**Broshurë informuese mbi  
NYSITELL-in për prindërit**

**Mirë se vini në sistemin shkollor publik të Shtetit të Nju Jorkut! Misioni i Departamentit Arsimor të Shtetit të Nju Jorkut (New York State Education Department's - NYSED ) dhe Zyrës së Arsimimit Bilingual dhe Gjuhëve të Botës (Office of Bilingual Education and World Languages - OBEWL) është të sigurojnë se të gjithë studentët e Shtetit të Nju Jorkut (New York State - NYS), përfshi këtu edhe Nxënësit e Gjuhës Angleze (English Language Learners - ELLs) / Nxënësit Shumë-Gjuhësor (Multilingual Learners - MLLs), të kenë sukses në nivelet më të larta akademike dhe kompetenca gjuhësore. Ne përpiqemi shumë për t'u siguruar që rrugëtimi arsimor individual i çdo studenti dhe nevojat e tij socio-emocionale të përmbushen në shumë gjuhë, duke i përgatitur ata për universitet e duke i aftësuar në karrierë.**

## **HYRJE**

Gjatë regjistrimit vutë në dukje se fëmija juaj ka tjetër origjinë apo gjuha e tij mëmë nuk është vetëm anglishtja. Një mësues intervistoi fëmijën për të parë nëse nevojitet një mbështetje shtesë në gjuhën angleze. Informacioni i mbledhur gjatë intervistës nxori në pah se fëmija juaj mund të kualifikohet për shërbimin ELL dhe mund të identifikohet si një ELL/MLL. Për të përcaktuar nevojën e fëmijës tuaj për një mbështetje të mëtejshme të gjuhës angleze, fëmija juaj do t'i nënshtrohet Testit të Identifikimit të Shtetit të Nju Jorkut për Nxënësit e Gjuhës Angleze (Test for English Language Learners - NYSITELL).

## **CILI ËSHTË QËLLIMI I NYSITELL-it?**

Qëllimi i NYSITELL-it është të vlerësojë nivelin e gjuhës angleze të nxënësit me tjetër origjinë apo që nuk kanë si gjuhë amtare anglishten. Pikët që fëmija juaj do të marrë në NYSITELL (Hyrja, Zhvillimi, Kalimi, Zgjerimi apo Zotërimi) do të përcaktojnë nëse ai apo ajo mund të përftojë shërbimet e ELL-së dhe do të vendosë nivelin e mbështetjes së gjuhës angleze. Rezultati gjithashtu do të ndihmojë mësuesit të hartojnë programin më të mirë për fëmijën tuaj duke u bazuar se sa i aftë është ai apo ajo dhe sa nevojë ka në dëgjim, të folur, të lexuar dhe shkrim të anglishtes.

## **KUR JEPET NYSITELL-i?**

NYSITELL-i u bëhet ELL-ve/MLL-ve të mundshëm vetëm pas regjistrimit në një sistem shkollor të Shtetit të Nju Jorkut.

## **ÇFARË LLOJ PYETJESH DO T'U BËHEN STUDENTËVE?**

NYSITELL-i përfshin pyetje me alternativa, pyetje me përgjigje të shkurtra dhe të gjata, pyetje me përgjigje orale gjatë dëgjimit, të folurit, të lexuarit dhe shkruarit.

## **SI MUND TË MËSOJ REZULTATET?**

Shkolla ku është regjistruar fëmija do t'i dërgojë me postë një letër lajmërimi për prindërit ku do të tregohet niveli dhe masa të tjera shtesë që duhet të ndërmerret. Nëse fëmija juaj identifikohet si ELL/MLL, do t'ju kërkohet të jini i pranishëm në një seancë orientimi ku do të mësoni rreth programeve të ELL-së që janë të gatshme për fëmijën tuaj.

## ÇFARË KUPTIMI KANË NIVELET E ZOTËRIMIT?

Në varësi të rezultatit të fëmijës, ai apo ajo mund të konsiderohet si ELL/MLL. Në tabelën e mëposhtme do të gjeni një përshkrim të niveleve të zotërimit:

Niveli	Përshkrimi i Nivelit të Zotërimit të Gjuhës Angleze	Kualifikohet për shërbimet
Hyrja (Fillimi)	Një student në nivelin e Hyrjes është shumë i varur në mbështetjen dhe strukturat për të zhvilluar aftësitë gjuhësore akademike dhe ende nuk përmbush kërkesat linguistike të nevojshme për të treguar zotërimin e gjuhës angleze në kontekste (mjedise) akademike.	
Zhvillimi (Mesatar i Ulët)	Një student në nivelin e Zhvillimit është disi i varur në mbështetjen dhe strukturat për të zhvilluar aftësitë gjuhësore akademike dhe ende nuk përmbush kërkesat linguistike të nevojshme për të treguar zotërimin e gjuhës angleze në kontekste (mjedise) akademike.	
Kalimi (Mesatar)	Një student në nivelin e Kalimit është disi i pavarur për të zhvilluar aftësitë gjuhësore akademike, por ende nuk përmbush kërkesat linguistike të nevojshme për të treguar zotërimin e gjuhës angleze në kontekste (mjedise) akademike.	
Zgjerimi (I Avancuar)	Një student në nivelin e Zgjerimit është shumë i pavarur për të zhvilluar aftësitë gjuhësore akademike dhe i përafrohet kërkesave linguistike të nevojshme për të treguar zotërimin e gjuhës angleze në kontekste (mjedise) akademike	

## KUSH HARTON DHE KORRIGJON TESTET?

NYSITELL-i hartohet dhe korrigohet nga mësues të kualifikuar të Shtetit të Nju Jorkut.

## NËSE FËMIJA IM KA IEP, A KA AKOMODIM TË POSAÇËM TESTIMI GJATË NYSITELL-IT?

Po, lejohen akomodime të posaçme testimi për nxënësit IEP gjatë NYSITELL-it. Flisni me mësuesin e fëmijës për të marrë të dhëna specifike mbi akomodimin që i takon fëmijës tuaj.

## ÇFARË SHËRBIMESH GËZON FËMIJA IM PASI AI APO AJO JANË IDENTIFIKUAR SI ELL/MLL?

Pasi fëmija identifikohet si ELL/MLL, ai apo ajo gëzon të drejtë për: shërbime të Arsimit Bilingual (Kalimi apo Dy-gjuhësh) dhe/apo Anglisht si një Gjuhë e Re (English as a New Language - ENL). Niveli i zotërimit të fëmijës tuaj përcakton detajet e shërbimeve ELL (orët e mësimave) që ai apo ajo do të kenë gjatë javës. Shihni grafikun poshtë për detaje specifike mbi nivelin e zotërimit.

Niveli	Klasat K-8 Detajet e Udhëzimeve e javore të ENL-së	Klasat 9-12 Detajet e Udhëzimeve javore të ENL-së	Studentët në Programet Bilinguale
Hyrja (Fillimi)	360 minuta	540 minuta	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Kurs Arti i Gjuhës Amtare</li> <li>• Minimumi dy lëndë me përmbajtje bilinguale</li> </ul>
Zhvillimi (Mesatar i ulët)	360 minuta	360 minuta	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Kurs Arti i Gjuhës Amtare</li> <li>• Minimumi dy lëndë me përmbajtje bilinguale</li> </ul>
Kalimi (Mesatar)	180 minuta	180 minuta	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Kurs Arti i Gjuhës Amtare</li> <li>• Minimumi një lëndë me përmbajtje bilinguale</li> </ul>
Zgjerimi (I Avancuar)	180 minuta	180 minuta	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Kurs Arti i Gjuhës Amtare</li> <li>• Minimumi një lëndë me përmbajtje bilinguale</li> </ul>

### PASI MËSOJ REZULTATET, SI MUND TË NDIHMOJ NGA SHTËPIA?

- Lexojini fëmijë në gjuhën e tij të origjinës/amtare dhe/apo në anglisht (studimet tregojnë se të lexuarit në gjuhën amtare ndihmon në mbështetjen e aftësisë së fëmijës për të lexuar dhe shkruar në Anglisht)
- Tregojini përralla fëmijës në gjuhën tuaj të origjinës/amtare.
- Shkoni në bibliotekën vendase dhe merrni hua libra me audio në gjuhën tuaj të origjinës/amtare apo në anglisht.
- Sigurohuni të jeni i pranishëm gjatë takimeve me prindër të caktuar nga shkolla juaj.
- Lini një takim individual me mësuesin e fëmijës tuaj për të mësuar mënyra specifike se si mund të ndihmoni fëmijën tuaj që të ketë sukses.
- Dedikojini kohë çdo ditë fëmijës tuaj për të bërë detyrat e shtëpisë dhe, nëse është e mundur, sigurojini atij një vend të qetë, pa asnjë shpërqendrim, ku të punojë.
- Planifikoni vajtjen si familje në muze. Ciceronët në muze mund t'ju ndihmojnë të shihni ekspozitën me fëmijën tuaj.
- Muzetë dhe bibliotekat shpesh ofrojnë një pasurim njohurish me kosto të ulët edhe/apo pa pagesë pas shkolle apo në fundjavë.

Për pyetje dhe shqetësime mbi shërbimet e ELL ju lutem kontaktoni  
[nysparenthotline@nyu.edu](mailto:nysparenthotline@nyu.edu)  
Linja e ELL-së e dedikuar për prindërit: (800) 469-8224

**Pyetje të tjera?**

Ju lutem na dërgoni pyetje a komente në Zyrën e Arsimit  
Bilingual dhe Gjuhëve të Botës [OBEFLS@nysed.gov](mailto:OBEFLS@nysed.gov)  
Ose na telefononi në: 718-722-2445  
Për më shumë të dhëna mbi NYSITELL vizitoni:  
<http://www.p12.nysed.gov/assessment/nysitell/>

